

Në bazë të nenit 184 të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe neneve 264 dhe 265 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Komisioni për çështje mësimore – shkencore dhe Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar, pas pranimi të Nismës nga Rektori i Universiteti të Tetovës **Prof. Dr. Jusuf Zejneli** për ndarjen e titullit **Doktor nderi - Doctor Honoris Causa** për **z. Rexhep Meidani**, e formoi Komisionin recensues, në këtë përbërje:

1. Prof. Dr. Jusuf Zejneli - kryetar
2. Prof. Dr. Salajdin Salihi - anëtar
3. Prof. Dr. Florim Idrizi - anëtar

Për këtë qëllim, si anëtarë të Komisionit recensues e kemi nderin dhe kënaqësinë e veçantë që deri tek organet e Universitetit të Tetovës ta paraqesim këtë:

## REFERAT

### **për dhënien e titullit *Doctor Honoris Causa* për z. Rexhep Meidani**

Universiteti i Tetovës, si institucion i arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që nga themelimi e ka si mision respektimin e figurave më të rëndësishme kombëtare, që janë të dëshmuar me të arriturat e tyre në shkencë, kulturë, arsim, shoqëri civile apo politikë.

Drejtuesit e Universitetit të Tetovës gjithmonë kanë shprehur respekt dhe nderim për z. **Rexhep Meidani**, një personalitet me të arritura të çmuara në fushën e shkencës, jetës akademike dhe politikës shqiptare.

Ne si komision e vlerësojmë punën publike, studimore, shoqërore dhe publicistike të z. **Rexhep Meidani** dhe e theksojmë me bindje se e meriton nderimin më të lartë të Universitetit të Tetovës.

Që t'i zbatojmë me përpikëri procedurat ligjore dhe statutare, e kemi hartuar referatin për shpalljen si **Doktor nderi - Doctor Honoris Causa për z. Rexhep Meidani.**

Me këtë Referat, që përmban pjesën biografike, arsyetimin e dhënies së titullit dhe pjesën përmbyllëse, i propozojmë Senatit të Universitetit, që ta miratojë Vendimin për lauerimin e z. **Rexhep Meidani si Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës.**

#### **I. Të dhënat mbi jetën dhe veprimtarinë e z. Rexhep Meidani**

Rexhep Qemal Meidani lindi në Tiranë më 17 gusht 1944. Ai është Doktor i Shkencave, Profesor, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (nga viti 2003) dhe anëtar i Jashtëm i Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve (nga viti 2015). Ka qenë Sekretar i Përgjithshëm i PS-së në vitet 1996 – 1997 dhe President i Shqipërisë në vitet 1997 –2002. Gjithashtu ka qenë pjesëmarrës në shumë aktivitete publike dhe sociale, ka botuar shumë studime dhe libra universitarë. Është anëtar nderi i shumë asociacioneve kombëtare e ndërkombëtare.

Profesor Rexhep Meidani është shpallur Doctor Honoris Causa nga Universiteti Teknik i Stambollit (1998); Universiteti Aristotel i Selanikut (1998); Universiteti i Sofies (1998); Universiteti Amerikan i Romës (1999); Universiteti i Mesdheut

Renè Cassin në Bari të Italisë (1999); Universiteti i Bridgeport-it, Connecticut, SHBA (2001); Universiteti i Portsmouth-it, në Angli (2002) dhe Universiteti New York Tirana, Shqipëri (2016).

Është nderuar me çmimet: F. Lux Award nga Universiteti Clark, Worcester, Massachusetts, SHBA (më 2000); Jan Masaryk Medal nga Universiteti Ekonomik në Pragë (2001) dhe Chancellor's International Medallion of Distinction nga Universiteti i New Orleans-it në SHBA (2002).

Ka marrë shumë dekorata, medalje dhe çmime kombëtare e ndërkombëtare për veprimtarinë mësimoro-shkencore, shoqërore e politike, siç janë: Urdhëri “Naim Frashëri”, Klasa e Tretë, Shqipëri, 1981; “Çmimi i Republikës”, Klasa e Dytë, Shqipëri, 1988; Medalja e Artë e Meritës (The Gold Medal of Merit) e Qytetit të Athinës, Greqi, 1998; Kryqi i Madh i Shpëtimit (The Great Cross of Salvation), Greqi, 1998; Medalja e Meritës (Medaille de Merite) Bashkimi Postal Universal, 1998; Medalja e Nderit (Honorary Medal) e Qendrës “Democritos”, Greqi, 1998; Urdhëri Kombëtar “Ylli i Artë i Rumanisë”, Rumani, 1999; Çelësi i Artë i Qytetit të Worcester-it, Massachusetts, SHBA, 2000; Urdhëri i Mbretit Tomislav, Kroaci, 2001; Çelësi i Artë i Qytetit të Pragës, Çeki, 2001; Medalja "Schuman", Fondacioni “Robert Schuman”, Paris, Francë, 2001; Urdhëri Kombëtar i Meritës, Maltë, 2002; Qytetar Ndërkombëtar Nderi i New Orleans-it, SHBA, 2002; Çelësi i Artë i Qytetit të New Orleans, SHBA, 2002; Medalja e Artë e Lirisë, Prishtinë, Kosovë, 2010 etj.

Në Shqipëri ka botuar mbi tridhjetë botime shkencore (monografi, broshura, libra universitarë dhe pasuniversitarë) dhe me qindra artikuj shkencorë, shoqërorë, politikë dhe biografikë, por edhe intervista, fjalime, analiza, etj.

Gjithashtu ka botuar studime edhe jashtë vendit, sikurse në Francë, Gjermani, Itali, Angli, SHBA, Hollandë, Turqi, Bulgaria, Greqi, Rumani, Kinë, Hungari, etj.

Ka botuar edhe libra filozofiko-shkencorë dhe politiko-publicistikë, sikurse:

1. *Mbi strukturën e materies në fizikë*, Tiranë, 1979;
2. *Entropia, SHB "8 Nëntori"*, Tiranë, 1981, 2017;
3. *Determinizmi dhe mekanika kuantike*, Tiranë, 1981;
4. *Mbi lëvizjen fizike*, Tiranë, 1985;
5. *Presidenti Meidani dhe Kosova (përmbledhje me intervista e fjalime)*, Tiranë, 2000;
6. *Ballkani, një vështrim i përgjithshëm (shqip dhe anglisht)*, Tiranë, 2001;
7. *Nga Pavarësia drejt Ndërvarësisë së Integritetit (shqip dhe italisht)*, Tiranë, 2001;
8. *Globalizimi, integrimi dhe kombi shqiptar*, Tiranë, 2002;
9. *Jus Gentium*, Tiranë, 2003;
10. *Politika, Morali dhe Shteti*, Toena, Tiranë, 2003;
11. *Kontratë me vetveten*, Toena, Tiranë, 2004;
12. *Kurthet e shtetit - komb*, Tiranë, 2005;
13. *Politika in vivo - in vitro*, Tiranë, 2006;
14. *Të vërtetat dhe të fshehtat e entropisë*, Tiranë, 2006;
15. *Las trampas del Estado - nacion*, Tiranë, 2007;
16. *A është deterministe teoria kuantike?*, Tiranë, 2007;
17. *Mbi hapësirë-kohën*, Tiranë, 2008;
18. *Kushtetuta, bilanci dhe perspektiva*, Tiranë, 2009.
19. *Mbi qeverisjen (tri pjesë)*, Tiranë, 2009 – 2010;

20. *Beteja për votën*, Tiranë, 2010;
21. *Rëniet-ngritjet e demokracisë*, Tiranë, 2011;
22. *Ndikimi filozofike të paradigmës ajnshtajniene*, Tiranë, 2015;
23. *Mbi ndërtimin e botës*, Tiranë, 2016 etj.

z. Rexhep Meidani ka botuar libra dhe kapituj librash që janë botuar në gjuhë të ndryshme.

## **II. Arsyetimi i dhënies së titullit Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës**

Për ne si Komision vlerësues ka qenë privilegj që ta mbështesim fuqimisht shpalljen e z. **Rexhep Meidani, Doktor nderi - Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës**, sepse, kështu, mbarë komunitetit akademik dhe opinionit publik ia përcjellim mesazhin fisnik se Universiteti i Tetovës i çmon personalitetet që kanë dhënë kontribut të çmuar për çështjen shqiptare.

Rexhep Meidani si shkencëtar është dalluar për punën e tij shkencore dhe kërkimore. Ka botuar shumë studime dhe libra në vend dhe jashtë, kurse si politikan është dalluar për qëndrimet e tij parimore, vizionare dhe demokratike.

Si President i Republikës së Shqipërisë (1997-2002), i shërbeu vendit me dinjitet, përkushtim dhe ndershmëri, duke promovuar stabilitetin rajonal dhe zhvillimin ekonomik.

### Propozim-vendim

*Duke pasur parasysh kontributin e çmuar dhe rolin e z. Rexhep Meidani në veprimtarinë shkencore dhe në çështjen shqiptare, ne si komision vlerësues, japim miratimin për dhënien e titullit **Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës z. Rexhep Meidani** dhe njëkohësisht i propozojmë Senatit, si organ më i lartë i Universitetit, që vlerësimin tonë ta marrë në konsideratë.*

Tetovë, nëntor 2025

Komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Jusuf Zejneli - kryetar



---

2. Prof. Dr. Salajdin Salihi – anëtar



---

3. Prof. Dr. Florim Idrizi – anëtar



---